VENDIM
Nr.582, datë 15.4.2005

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.390, DATË 15.8.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E DISA OBJEKTEVE SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.390, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa:

1. Në listën bashkëlidhur pas numrit 9, të shtohet numri 10, me këtë përmbajtje:

"10. Godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.".

2. Në pikën 4, pas emërtimit "Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit", të shtohet "Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano